



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 53, datë 31.03.2023

**PËR
MIRATIMIN E TABELËS SË PRIMIT TË RREZIKUT PËR PËRLLOGARITJEN E
PROVIGJONEVE TEKNIKE PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM TË
PËRGJEGJËSISË SË PRONARIT TË MJETIT MOTORIK, PËR DËMET QË U
SHKAKTOHEN PALËVE TË TRETA NGA PËRDORIMI I KËTIJ MJETI, TË
SHOQËRISË SË SIGURIMIT “ANSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 7, të ligjit nr. 32/2021, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit” dhe pikës 22, të nenit 14, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e tabelës së primit të rrezikut, për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjesisë së pronarit të mjetit motorik, për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjete, për kontratat e sigurimit MTPL e brendshme (tabela bashkëlidhur këtij vendimi).**
- 2. Shoqëria publikon primet e rrezikut, si dhe primet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, në faqen e saj të internetit dhe i mban ato të afishuara gjatë gjithë periudhës së zbatimit.**
- 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**

Tabela: Primet e rrezikut të shoqërisë “**Ansig**” sh.a., për llogaritjen e nivelit të provigjoneve të sigurimit të detyrueshëm të përgjegjësishë së pronarit të mjetit motorik, për dëmet që u shkaktohen palëve të treta nga përdorimi i këtij mjete, për kontratat e sigurimit **MTPL** e brendshme:

Kateg.	Klasa	Tipi	Kapaciteti motorik (cm3)/ ose pesha mbajtëse (T)/ ose numri i vendeve	Tarifat e primit të rrezikut të përlogaritura (në Lekë)
A 1		Motorçikleta	Kapaciteti motorik	
	A 1/1		Deri në 150 cm ³	2,800
	A 1/2		Mbi 150 cm ³	4,200
B 1		Autovetura	Kapaciteti motorik	
	B 1/1		Deri në 1600 cm ³	6,500
	B 1/2		Mbi 1600 cm ³	8,700
B 2		Furgona, Mikrobusë	Numri i vendeve	
	B 2/1		Nga 5 deri në 8 vende	12,100
	B 2/2		Mbi 8 deri në 15 vende	16,500
C 1		Autobusë	Numri i vendeve	
	C 1/1		Mbi 15 vende	27,000
D 1		Kamionçina	Pesha mbajtëse (Ton)	
	D 1/1		Deri në 3.5 ton	11,600
D 2		Kamionë	Pesha mbajtëse (Ton)	
	D 2/1		Mbi 3.5 ton	19,000
E 1		Rimorkio	Pesha mbajtëse (Ton)	5,600
F		Mjete bujqësore		4,400
G		Zjarrfikëse		9,900

*Tarifat e aplikuar për shitje mund të ndryshojnë ndjeshëm nga primi i rrezikut.